

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8521-1

8 32

ILIA S. DEDE

Y
suaji

POEZI

814-1
032

ILIA S. DEDE

JU A J I

poezi



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

BURONJA

Burime... burime...

I pastër buron njëri në të çarën e shkëmbit,
i vrullshëm shpërthen tjetri mes gurësh të bardhë.
Pranë ujërave të kulluar drurët tundin gjethet
a thua gurgullima i kthen në valltarë.

Pranë rrjedhës së tyre do të doja
gurgullimën tërë jetën t'ua ndieja pranë
e ujërat burimeve t'ua pija.

Kaq shumë burime
nuk kam parë në asnjë vend
ndaj Buronjë e quajtën kuçiotët emrin tënd.

Tek ky vend kish luftuar me tre armë
heroi, për të cilin do të shkruaja skenarë.
S'lashë strall e lëndinë pa shkelur me këmbë
e për kujtime takova bashkëluftëtarë, fshatarë.

Të bukur ia kishin bërë varrin me mermer të kuq,
të lartë ia kishin ngritur lapidarin e bardhë.
Krahina kish shumë këngë për të,
i këndojnë sa herë ndiejnë mall.

Burime të shumta këngësh
burojnë të pastër nga zemrat e bashkëlufëtareve,
shpërthejnë të vrullshëm — shpirtit të djemve e
vazave.

Pranë rrjedhës së këngëve u tundën zemrat
si shamat e kuqe në valle.

Burime e këngë
dhe «Buronjë» e quajnë këtë vend.

KUR PRINDËRIT URONIN VËLLANË E MADH

Sa herë u sillje prindërve
dëftesën e klasës së parë,
diplomën e fakultetit,
të uronin prindërit, vëllai im i madh!
Urimet e puthjet e tyre pas të ndoqën në udhë.

Ti ecje më tej
ne të ndiqnim pas.

Po kur u ktheve nga stazhi i Partisë
e ndiemë të gjithë vëllezërit e motrat
puthjen me urimin e fortë:
— E kuqe, si tesera e Partisë, udha të qoftë!

Këtej e tutje
do të të ndjekim në gjurmë të kuqe.

VAJZAT E ANSAMBLIT ARTISTIK TË KOOPERATIVËS

Mes rapsodëve të vjetër
rrinin vajzat këngëtare,
si lulëkuqet në grunare.

Duart e tyre lidhën duaj në ara,
e pasi mbushën lëmenjtë me grurë
vajzat ngjitën skenën, të këndojnë e valle të hedhin
me vrull.

Me nota këngësh e ritme vallesh
grunore e mbarë zemra e tyre
në lëmë e kthyen vajzat skenën e kësaj shtëpie
kulture.

FLETORJA E BARIUT

Me gjuhëzat e kuqe kecërit çapkënë
i lëmonin pëllëmbën bariut,
si dhjetëra flakë e përkëdhelnin në shpirt.
Ndjeva, zjarri i kënaqësisë ta ngrohte,
i shihja dritën e flakëve tek sytë.

Më kishin thënë shokët se ishte i thjeshtë,
një fletore e bënte të veçantë këtë bari.
Vetë e mendonte më të zakonshmen fletore
ndaj i drojtur e fshihte në xhepin e brucës ai.

Dhe mendova se zemrën e tij fshihnin ato fletë
që po t'i hapja sikur do shtyja lesën e vathës,
sikur do shkundja fletët e trendelinës e do trembja
thëllëzën,
si i ka rrahur pranë vajzës do t'ia ndieja zemrën.

Dy ditare bashkë na qenkëshin në atë fletore;
për kecërit e lindur e qumështin e dhive — më i ho-
llësishmi ditar,
ku numra vitesh e shifra qumështi
bariu kish shënuar vite me radhë.

Tek ato shifra gjente moshën e kohës më të mirë
për prodhushmëri të lartë në qumësht
me nuhatjen prej shkencëtari të heshtur.
Në fletore bariu mbante
shqetësimin e tij të madh.

Kur qumështi fryn gjinjtë e dhive
e rrjedh si përrenjt e prillit,
kur blegërijnë kecërit e porsalerë e fytyrën ia ngrohin
me frymë,
bariu ndihet më i lumturi.
A ka gëzim më të madh për barinë?

SHQETËSIM I NJERIT BREZ PËR TJETRIN

Kur plagët e luftës, plagët e punës
të freskëta si lulekuqe mëngjesi i kishit
nuk i ndienit, veteranë.

Koha ua ftohu tani,
me dhembjen e tyre mosha ju mundon.

Po ju të fortë mbaheni
në hapje brazdash, në ndërtime veprash pesëvje-
çarësh,
ku ne lartësojmë veten,
na rrini pranë.

Më tepër se dhembja e plagëve të luftës e të punës
ju mundon shqetësimi
të na lini pas më mirë se veten tuaj, veteranë.

NGA BALTA E ARAVE

Plugu përmbyste plisat e tokës,
a thua trazohej prushi i një zjarri të madh.
Tek vazhdonim bisedën e nisur në zyrën e kryetares
ndienim
si toka na ngrohte me vlagën e saj.

Nuk ishte e vështirë pyetja ime,
kryetarja druhej të fliste për vetveten.
Plisat e ngrohtë të tokës, fëshëferimën e grunjërave e
zemrat e fshatarëve
ndieja të më përgjigjen.

Fjalët e fshatarëve ngrohnin si plisat e porsalëruar
kur flisnin për kryetaren e tyre të mirë,
sikur avulli i brazdave të reja
në fjalët e tyre kish hyrë.

Nëntë vjet mund t'i numërosh me gishtat e dorës,
nëntë vite janë pak për të njohur

zemrat e fshatarëve e plisat e tokës.

Po me peshën e shqetësimeve për rendimente të larta
rëndojnë nën të vitet e saj të punës.

Mbrëmjeve, kur hënâ varej mbi fshat si bohçe e hapur
pambuku,

me hap të rënduar nga balta e arave

ajo kthehej në shtëpi,

ku nëna e shqetësuar e priste me fjalë të ngrohta e
kafe.

Ashtu si toka bujarinë nuk ta jep lehtë,

fshatarët s'ta dhanë besimin për moshën e re apo

ëmbëlsinë e fjalës;

ashtu si balta e fushave, që s'tu shqit nga këmbët,

nga mendja s't'u nda shqetësimi për zemrat e fshata-
rëve e plisat e tokës.

Buzëqeshja jote, motër, më duket e madhe,

thua se grunjërat ta shumëfishojnë,

kryetare.

NUHATJE

Mbrëmje për mbrëmje gjyshi im
dilte tek toka,
si farën e hedhur brazdave, zemrën ia ngrohte vlaga.

Nuk shfletoi buletinet e stacionit metereologjik,
syri i tij e lexonte kohën në qiell.
E nuhaste tek fluturimi i shpendëve, ngjyra e reve,
të nesërmen e kohës e njihte në diell.

Ç'e mësoi gjyshin tim të nuhasë të nesërmen e kohës?
— Shqetësimi për bimën,
jeta pranë brazdave, dashuria për tokën.

KUR PO MBLIDHJA MATERIAL PËR SKENAR

Do shkruaja skenarin e një filmi
për heroin që kish luftuar me tre armë.
Vajta në vendet ku gjerdani i tij zbraz
fjalën e Partisë, fishekë, e këngë.

Kërkova të më tregonin shtëpinë ku rrinte,
dhomën ku u mësonte vajzave këngët e tij,
vatrën ku ndezi zjarr. ,
Është kjo dhomë... kjo vatër... ky fshat
e kështu u bë krahina e tërë.

Kërkova të më takonin me ca bashkëluftëtarë
që maliherin e heroit e njihnin në krisëm, ligjërimin
e tij në zë

e prushi i zjarrit të tij i ngrohte akoma.
Mbi mua derdheshin të pastra e të vrullshme kujtimet
e tyre
siç varej malit e shkrirë dëbora.

Në se nëpër muzetë e qyteteve
vetëm ciceroni më foli për këtë hero,
tek fëmijt' e krahinës kuptova
se jetën e heroit e njihnin — si gërmat e abetares ata.

Nëpër njerëz të shumtë ndjeva se për heroin
respekti i popullit — deti më i thellë;
nderi i popullit — mali më i lartë.

Në majën e lartë të nderit hipur,
në thellësinë e respektit popullor,
shqetësohesha për skenar.

LIQENI I LULEVE DHE LEGJENDA E VIRGJËRISË

Ç'ke kështu e dashur?
Ti dridhesh e tëra si ujët e këtij liqeni.
Veç luleve të rralla, ujërat e kaltra legjendën e
vajzave krutane fshehin.

Moshatareve të tua u mbeti gonxhe ëndrra për nuse,
nuk e ndalën vrapin e vajzërisë në krahët e djemve.

Ëndërronin përkëdheljet e pëllëmbëve të ngrohta
po djemve u mbetën duart n'jataganë.

Pas i ndoqi këmba e turkut si këmba e ujkut
po në gurë e shkëmbinj vajzat vraponin,
duarlidhur me njëra-tjetrën sikur vallen e dasmës
së tyre luanin.

I shihnin liqenet e bëheshin më të kaltër,
i shihnin malet e bëheshin më të lartë,
vajzat që me vellon e madhe të ujërave mbuluar,
nuse u bënë në një ditë.

DHJETË VARGJE PËR NIPIN E PARË

Fëmijët gjithnjë e presin pranverën
me fole për zogjtë në degët e pemës.

Në zemrën tonë, Bledi, të bëmë nga një fole
kur të prisnim atë natë ne.

Trupi yt i larë në vesën e mëngjesit,
sy e buzë prerë në ëmbëlsinë e qiellit.

Të qarat e tua — zëri i parë i jetës,
turpërojnë burimin e dridhjen e fletës.
Vetëm tani, Bledi, mund të jesh i qetë.
Degë të lulëzuar shqetësimet të bëfshin në
shpirt!

INICIALE SHKRUAR ME GJAK

(Kufitarit B. Buza)

Me tërë ato plagë
të rënda si copëra shkëmbinjsh në trup,
Bendo Buza akoma në këmbë.


Luftën e Bendos me sy nuk e pamë,
si ra ai
plagët na e thanë.

P.E — si fjalët e para të jetës,
me bojë i shkroi Bendua
në bardhësinë e letrës.

P.E. — si fjalët e fundit të jetës,
me gjak i shkroi Bendua
në shkëmbin e qëndresës.

Para incialeve të kuqe n'atë shkëmb,
ndiejmë që tërë jetën i kishe

Partinë dhe Enverin në gjakun tënd.



12.10.64

ANTIFETARE

Jo në ujin tënd të bekuar
po në djersën time pagëzova vetveten
dhe ja ku jam
i rritur, i shëndetshëm, tërë jetën.
Rri mes njerzëve të mi
si i tyre poet.

Dhe u them
se kisha vërtet nuk rri mbi muret e saj,
pa veladon prifti, pa mjekër,
po ca gurë nga themelet e kishës,
diku, pa shkukur kanë mbetur.

PËR KOMUNISTIN GJIN

Pas shtrëngimit të dorës që ka rrëzuar pyje të tërë,
pranë fytyrës përkëdhelur ashpër në acare,
pas gjurmëve të këmbëve,
që shtigje të bardha kanë çelur në male,
diçka përtëritëse ndieja thellë vetes,
ndjenjën e madhe të më ngrohte...

Më shumë se me dëborë qyteti me vështirime më
mbuloi,
nuk më çuditi aq me bardhësinë e papërsëritshme të
peisazheve
sa me mirënjohjen e syve të njerëzve, ky qytet malor.
Udhës, tek ecja me Gjinin,
në tavolinë ulur me të
e tek hyja në shtëpinë e tij, më kishin parë.

E ndieja ngrohtësinë e këtyre njerëzve,
tek malësorët që më hapën kutinë e duhanit,

tek bisedat me njerëzit ulur në tavolinë,
e ndieja mirënjohjen në përshëndetjen e njerëzve të
panjohur
udhëve të qytetit alpin.

E. kishin mësuar këta njerëz të mirë e të thjeshtë
se për komunistin Gjin
do shkruhej në gazetë.
Gëzimi i njerëzve për Gjinin e dashur e punëtor
mbuloi qytetin
më tepër se kjo dëborë.

BUKË PËR ATDHEUN

Kodra me lartësi mesatare:
brenda minierë, sipër grunore.

Dikur quhej kodër e egër,
mineral fshihte brenda, tokë buke sipër.

Erdhën minatorët një ditë,
thellësive të saj çanë galeritë.

Duart e kooperativistëve e kthyen në arë,
lëruan brazda e hodhën farë.

Kalliri i grurit e copa e mineralit
shqetësim i bujkut, shqetësim i minatorit.

Duaj gruri sipër, vagona minerali nën tokë,
njerëzit e punës nxjerrin për atdheun bukë.

B O R O V Ë

Nënat nuk kishin fshehur gjinjt' e vakët nën bluza,
fëmijëve qumështi në buzë akoma nuk u ish tharë,
kur dhembja të rrudhi fytyrën, Borovë, durimi t'u
bë strall.

Dritaret, dyert, trarët nuk ishin më dru,
shtëpitë jo më shtëpi
dhe foshnjat po e ndienin se nuk ishin më fëmi.

Vërtet pa nëna mbetët, fëmijë,
po pa t'ardhme jo kurrsesi.

Na e shuan Borovën, na e bënë thëngjill
dhe ne mangut nuk ua lamë:
fundin ua bëmë si Borova.

NË DITARIN E DITËS SË PARË TË DASHURISË

Tek njëri-tjetri erdhëm një ditë
pa fleta me poezi në duar,
me sytë, zemrën, buzët, fytyrën...
ku mbanim vargun më të bukur:
të dua... të dua.

Poezia e shpirtit tim,
poezia e shpirtit tënd, e dashur, —
si hallka më e pazgjidhshme për të na mbajtur.

TEUTA

*Kur diplomatët romakë i kërkuan
mbretëreshës Teutë një copë tokë
dhe pak ujë, ajo i hodhi në pus.*

Nga historia

S'e linin të qetë romakët tokën tonë,
ashtu si dallgët bregun e detit, Teutë.
Ndaj nuk arrije ta hiqje veshjen e luftëtares,
e zakonshme t'u bë kjo veshje në trup.

Përkrenaren mbi kokë,
heshtën në dorë,
mburojën në kraharor mbaje ti.
A thua bënin pjesë, Teutë,
me trupin tënd në një anatomi?

Romakët të kërkuar një copë tokë e pak ujë,
ti ndjeve se majën e heshtave shihnin fjalët e tyre
e iu përgjigje si e kërkon çdo agresor.
Gryka e pusit i gëlltiti
të tillë përgjigje nëpër kohëra armiqtë kanë marrë!

U BUZËQESHTE TOKA

Vajzat si flokët e tyre tufsh
kaçube. . . kaçube lidhnin
misrin e korrur në fushë.

Gishtërinjtë e tyre u zhvishnin kallinjve fletët e
bardha
e u dukej sikur dhjetëra buzë
buzëqeshjen zbulonin ngadalë-ngadalë.

Pas zhveshjes së kallinjve të plotë me kokrra
vajzat ndienin
t'u buzëqeshte toka.

Pas plugimeve në netët me hënë,
pas prashitjeve e ujitjeve të ditëve me diell,
pasi i ke ndenjtur pranë si nënë
buzëqeshje të tillë toka të sjell.

P È R C J E L L J A

Valët nxitonin drejt bregut
si fëmija tek krahët e hapura të babait.

Mbi kraharor i rrinte vajzë e vogël detarit
sikur luante me detin dukej në krahët e tij.
Duart e vajzës përkëdhelnin rrudhat e thinjat e babait
si krahu i pulëbardhës valët e shkumën përmbi.

Nëpër detra e oqeanë përtej,
vajzën në krahë do ta ndiej.

Humbi vapori mes detit e qiellit
po vajza i tund dorën në breg.
Kur krahët e pulëbardhave do shohë,
detarit do t'i duket sikur tundja e dorës së vajzës e
ndjek pas në det.

HIDER KOKËS¹⁾

Fshatarët më kishin porositur
poezisë për ty, Hider, t'i zgjedh fjalë,
si bujqit grurin për farë.

Praqet e shtëpive e plisat e tokës
e njihnin hapin tënd, sekretar.
Fjalët e tua për bujqit e porsaçliruar ishin si dielli
e vlaga për farë.

Toka ish mbarsur me grurin e tretë,
gruaja jote, Hider, me fëmijën e parë.
Për bukën dhe fëmijën kish lidhur gonxhen e pritjes
shpirti yt i bardhë.

Pas gurëve e drurëve në errësirë, të ruante nepërka e
kulakut,

1) Sekretar Partie në zonën e Shijakut vrarë nga bandat kulake më 1947.

dhemb i saj të pickoi një natë.
Kur mes plisave të gjetëm, sikur grurin e tërë arave
na kishin shkelur me këmbë.

Zinë për ty, Hider,
na e prishi gazi i të korrave,
na e prishi gazi i fëmijës.

Malli për ty na është bërë det,
vështirë e kanë në të
nëna, gruaja, fëmija. . të gjithë.

Çdo plis i tokës të rri lapidar,
gruri e misri i harlisur me duaj e kaçube
kurora e buqeta për ty, sekretar.

DETARËVE QË S'DUAN TË DALIN NË PENSION

Fëminija juaj e shqetësuar në pelena dallgësh.

Djepi rritjes suaj — u bë varka e drurit
dhe duar nënash u bënë valët.

Deti ju rriti me përkëdheljet e tij të ashpra
si rrisin fëmijët e tyre spartanët.

Më tepër se dritën në tavanin e shtëpisë keni parë
hënën.

Më shumë se me gruan ndënjët me detin
dhe dallgët i ndjetë në gjoks më shpesh se fëmijët.

Nuk e kemi lehtë ne të tokës të kuptojmë
pse ju më shumë se trazirave detare i trembeni pen-
sionit,

pse ditët e tij të qeta
me ditët e stuhive detare, një mijë herë s'do t'i
ndërronit.

Zemra juaj, detarë,
më fort mbi valë mund të rrahë.

PRANË VIJËS SË KUFIRIT

Kapërceva pragun e shtëpisë,
po tek vija e kufirit m'u duk se nisin praqet e shtëpive
tona.

Ndaj këtu e ndieva veten fare pranë
babait, motrës, fare pranë tek nëna.

Tek kjo vijë
dhe pse nën akujt e ftohtë, mes erës së dëborës,
më ngjau vetja si në prehrin e nënës.

Dhe mendova
se në rënça për këtë vijë
brenda prehrit të nënës jam.
Asaj do t'i dukem dhjetë herë më i gjallë, dhjetë herë
më i ri.

Ndaj këtu në vijën e kufirit
më duket vetja
pranë kujt do më afër se kushdo
e më shumë më ngroh me zjarrin e saj çdo dashuri.

Pranë kësaj vije
sytë më shohin me forcën e miliona syve.
(A thua miliona sy kam brenda qepallave.)

Pranë kësaj vije,
ku të papriturat fshihen pas drurëve e gurëve,
zemra fort më mban.
A thua miliona zemra më rrahin në kraharor.

Pranë kësaj vije
arma në supin tim nuk lëviz
thua se në miliona supe e mbështes.

Dhe më vonë, sado larg saj të jem,
veten gjithnjë
pranë vijës së kufirit do ta ndiej.

Tek kjo vijë —
Atdheun e ndiej në supet e mi.

NJOHJA E PLAGËVE TË TUA, BABA

Ju luftuat në dimrat e vjeshtat e luftës,
kur qiejt hidhnin pa prerë borëra e shira,
po atëherë s'e ndieje që ata i mbeteshin trupit tënd
në shpatull... në këmbë e në dorë, baba.

Prushi i vatrave të thau rrobat,
çorapet, këmishën e xhakaventën,
shkarpat e malit të ngrohnin trupin e mardhur.
Tërë pyjet të digjeshin
nuk mund ta thanin trupin tënd të qullur.

Më të madh se dhembja e kishe shpirtin, baba,
ngjet kështu kur lufton për lirinë e popullit tënd.
Paçka se mirrje shumë plagë,
paçka se dimrat e vjeshtat të lanë reumatizmën —
gjemb,

Tani sa herë vrenjtet qielli e lëshon dëborë
zgjohet dhembja jote në trup e të rëndon mbi
gjymtyrë.

E fshihni, baba,
po ne e ndiejmë se gjumë të shqetësuar bëni netve,
se dhembja ju rri rrudhave në fytyrë.

Të ndiejmë pranë në punë e në jetë,
thellësinë e shpirtit ta kemi matur e vendin e plagëve
ta dimë ku i ke.

Historinë e luftës, historinë e fitores mëson,
me njohjen e plagëve të tua çdo njeri nga ne.

Udha jonë është e vështirë,
ngjitja jonë e lartë
po nuk epemi ne bijtë me të tillë baballarë.

EPITAFI ME GËZHOJA

Copëra shkëmbi,
gurë të ngjyrshëm zajesh kish mali
po nuk ia shkruan me to epitafin një luftëtari.

Dora e tij betejave që shtiza e flamurit,
armës së tij i dëgjohej në luftëra
krisma e parë e krisma e fundit.

Ndaj shokët mblodhën gëzhoja fishekësh
t'i shkruanin epitafin mbi kokë.
Qoftë i paharruar kujtimi yt, shok!

Gëzhojat e epitafit t'i kesh gjerdhan mbi varr.
Erërat të fryjnë... shirat të bien
nuk fshihet epitaf i tillë, luftëtar.

VAJZA QË MËSOI TË QËNDISË PRANVERËN

Me gjunjët e mbledhur qëndisje në gjergjef
pas xhameve të dritares,
tek oborri ndën pjeshkë.

Nuk kish zog në hapësirë,
nuk kish lule në lëndinë
të mos i qëndisnin duart e tua.

Me duart e vockëla e ktheje pëlhurën në kopsht,
me duart e njoma ktheje pëlhura në qiej.
Të ulje yje në bustinë, vajzë, si arrije?

Dhe nuk vyshkeshin lulet e tua,
dhe nuk ngjireshin zogjtë së cicëruari.

Ti, vajzë, që lulet i qëndisje të çelura,
pse nuk hapje kurorën e ëndrrave të tua?
Doje t'u ngjaje zogjve që duke fluturuar i bëje
në pëlhurë.

Jo pranvera e qëndismave,
vajzë, të duhej tjetër pranverë.

Dhe prisje pranverë më të madhe,
një mëngjes u nise
në male.

Do qëndisje me tjetër gjilpërë,
do qëndisje në tjetër pëlhurë;
sa vështirë!

Në gjergjefin tënd të gjerë sa horizontet
vure të ardhmen e bardhë të Shqipërisë,
gjithçka të bukur dora jote të qëndisë.

GËZIM I VEÇANTË FAMILJAR

Për ditëlindjet, dasmat tona, lindjet e nipërve
e në festa të tjera gëzimesh jemi mbledhur familja-
risht,
po ne asnjëherë nuk jemi ndier aq të lumtur
sa në përvjetorin e tridhjetë të babait si komunist.

Gëzoheshim për tridhjetë vitet e tij si anëtar i Partisë,
se udhës sonë babai ia dha drejtësinë,
se jetës sonë babai ia dha ngjyrën
se rritjes sonë i vuri qëllimin: për Partinë.

Tridhjetë vjet i ka thënë vetes. . — Kam bërë pak për
Partinë.

E ka dashuruar gjer në sakrifica, tridhjetë vjet.
Me nuhatjen e tij klasore dallonte
kush ishte gurë, kush ishte mineral në jetë.

Tridhjetë vjet e vlerësoi taserën e anëtarit të Partisë
si fletëthirrje të mobilizimit të përhershëm luftarak:

Për luftën e madhe, betejat e ashpra klasore
në çdo minutë, në çdo orë, në çdo vit. . .

Dhe në pyetshi: Ç'veti ka babai im?

— Dhjetë cilësitë e anëtarit të Partisë.

Kë ruajti të pastër, kë mbajti më lart?

— Tërë jetën emrin Komunist.

Gëzoheshim në këtë jubile të babait tonë,

e ndienim se festat e ardhshme të gëzimeve, udhët
tona në jetë,

e kanë burimin e nisjen tek qënia e tij.

Tërë jetën i ndershëm, luftarak e komunist.

KUR LINDIN QENGJAT

Nata më zu mbrëmë në një stan,
Në një zjarr u ngroha me barinjtë.
Qumësht delet qengjave u dhanë,
u buronte qumështi nga gjinjtë.

Ç'ka delja vallë, që blegërin?
Barinjtë e dhembshur pse i rrinë pranë?
Këtë çast më kujtuan maminë,
maminë e lumtur e fëmijën që qan.

Delja bëri qengj të bardhë, të bardhë,
dhe bariu e futi nën gunë.
Mëngjes u bëra në fytyrë
kur qengjin e ngrohtë mbaja unë.

E dini, festuam lindjen e qengjit në stan,
ngrita dolli me një kupë qumësht t'ngrohtë:
«U bëftë qengji dele, o çoban,
dhe tufa e bardhë u shtoftë!».

1970.

NË KLUBIN E DETARËVE

U ndodha në klubin e detarëve,
mëngjesit kur mbliidhen peshkatarë të vjetër e të rinj.
Në freskinë e bisedave ndieja kaltërsinë e valëve,
në fytyrat e tyre pashë relievin uJOR dhe stërkalat
në shkëmbinj.

Kthenin filxhanin e kafeja nuk ua rrudhte buzët,
se tërë jetën ua trashën valët me kripë.
Si kafënë e mëngjeseve
dhembjet e detit, detarët kanë pirë.

Mes gjallërisë së historirave e shakarave ulem unë,
shakarat e kripura — si ujët e detit nuk i ndajnë nga
vetja detarët.

Mes tallazeve kuvenduan me zhurmë
ndaj oshëtimë në zë u lanë valët.

Në thellësi detarësh përherë kështu qofsha!
U ndodha në klubin e tyre, u ndodha. . .

GJUMI I NJERIÛT TË VOCKËL

Në shtratin me çarçaf të bardhë, të ngrohtë,
në qoshkën e ndërgjegjes akull të ftohtë,
njeriu i vockël bënte gjumë.
Në rrugicat e braktisura të mendjes së shkretë
si kalimtare të vonuara
bridhnin thashethemet dritëverdha.
Me ritmin e çrregullt botë e vogël trokiste
dhe drita e zemrës së tij ishte e zbetë.
Në gjumin e moçalisur
njeriu i vogël ish larg
jetës që e thërriste me miliona tinguj e ngjyra;
me refrenin e tyre të ngjirur guak-guak,
guaknin thashethemet si bretkosa të fryra.
Në shtratin me çarçafë të bardhë, të ngrohtë
ia derdha njeriut të vockël vargjet dhe unë
që të rrëqethej nga drithma e ftohtë
se s'më pëlqente ai gjumë.

1970.

RRJEDHA E KËNGËVE TË TIJ

(Memo Metos)

Ai ishte gjithnjë i frymëzuar
e këngë buronte natyrshëm
si ujët e tij burimi.

T'ia mblidhja në një rrjedhë rrëkezat e këngëve
më shqetësonte kërkimi.

Dorëshkrimet ia kishin djegur bashkë me shtëpinë,
çanta e këngëve nuk i ra motrës së tij në dorë,
partizani që e kish marrë për ta ruajtur
diku mes malesh ishte vrarë.

Në eksponatin e muzeumit rrinte vetëm stilografi i tij
i hapur, me bojë në majë,
a thua kështu pas këngës së fundit e kish lënë.
Dora e tij nuk e mori më
se me gjak i shkroi lirisë tjetër këngë.

Mendoja për këngët e poetit ku ishin shpërndarë...
Befas ndiej gurgullimën e përroit që rridhte pranë,
rrjedha e tij humbi pyllit nëpër drurë.

Ndieja t'i murmurisnin qindra buzë këngët e Memos
si gurgullimën e përroit që akoma nuk e shoh.
Në popull kërkoja rrjedhën e këngëve të tij,
populli — shtrati më i mirë për to.

Ndjeva si këngët e poetit
në një rrjedhë mblidheshin, buzëve të popullit.

QËNDRESA E NËNËS

Sa rrufe pikëllimesh i ranë shpirtit tënd!
Të qe shkëmb do thyhej e copëtohej,
të qe dru do digjej e shkrumbohej.
Po qe shpirti nënës
me djaln partizan e vajzën komisare.

Zemrën tënde
që e lëndonin guriçkat e njomë të fëmijëve,
si nuk e tundën trupat me barut e plagë
të bijve...?

Pas rënies së çdo biri e çdo bije
zemra të ngrihej më lart,
si lartësi të reja krenarie.

NJË MENDIM

Kumbulla e oborrit tim i ka lulet si flutura,
kur isha fëmijë me të zemërohesha,
pse nuk i mbante tërë lulet e çelura?!

Dhe qortova erën
po kur u rrita mësova se fajin e ka rrënja.

Shpirti im lidh shumë shqetësime të ndershme
po nuk çelin të tërë.

Me kë të zemërohem,
me veten a me moshën?!

Tek mua ndodh si tek kumbulla,
ndiej se tek njerëzit po më rriten rrënjët.

DETKËS, SHOQES SIME

Kam njohur një vajzë,
kur i shkelte këmba mbi lëndinë,
kur buzëqeshte nga goja i derdheshin trëndafilë.
Sytë e lotuar i pikonin margaritarë:
vajzës që njoha në një përrallë.

Detkë e thërrasin shkurt shoqen time,
të kujton detin në emër, në valëzimin e flokëve, në
sy,
po më tepër ta kujton detin në shpirt,
gjuhën e ka valë, gjuhën e ka dallgë.

Druhesha,
nuk i thoshja asnjë fjalë të ashpër,
kujdesesha për miqësinë si të ishte qelq
dhe vetë nuk e kuptova si u mësova
të dëgjoj qortime nga kjo vajzë.

Thellësitë e detit më duken cektësira,
hapësirat e tij të ngushta para shpirtit të saj,
ndaj ta kesh shoqe Detkën nuk është lehtë.
Kur më flet për poezinë, dashurinë dhe jetën
më duket vetja si mbi det.

Ç'i morëm njëri-tjetrit... ç'i dhamë njëri-tjetrit?
Mbi dobësitë e thërmuara shkelnim.
Për të hyrë më thellë...
Në doni ta mësoni, njihuni me Detkën
kështu portretin e saj po ju sjell.

Sikur tërë kaltërsitë, thellësitë, hapësirat detet të
mblidhnin
s'do mateshin me shoqen time, Detkë.
Këtë vajzë e takova në jetë.

PARTIZANES QË KËNDONTE NË QYTETET E ÇLIRUARA

Pasi heshtnin pushkët
në qytetet e çliruara
frynte puhiza e këngëve të tua.

Ti hapje buzët, kudo hapeshin dritare
dhe pyesnin: — Nga fryn kjo erë kaq e ngrohtë?
Nga shpirti yt
ku pranvera kish buisur me kohë.

Davariteshīn mjegullat e armëve,
merrnin arratinë,
këngët e tua të kishin qiell më shumë.

Bardhësia e dëborës,
reflekse zjarresh
tek këngët e tua mësuar në male.

Kisha dëgjuar për motrën e Gjergjit,
që plagët e vëllait i lante me lotë
e gjakun ia terte me flokët e ballit.

Kur këngët e së ardhmes këndoje, Feride¹⁾,
shokëve u mbylleshin plagët
sikur i ngrohje me mijëra zjarre.

Për qytetin e fundit kishe mësuar më të bukurën
këngë.
Plumbi të mori në betejë po prapa buzëve s'të
mbeti kënga,
qindra buzë u hapën për të e çelën qindra zemra.

1) Feride Xhaferri, partizane e Brigatës XVI S.

KRENARIA E TOKËS SONË

Nuk i ka mbajtur kurrë të huajt ky vend
si toka pranë detit dëborën mbi vete.

Në se erdhën të shkëlin zëmrat e nënave
vjeshtë iu bë flamujve të huaj.

Kë nuk ka vjetëruar, kë nuk ka përtharë,
në solucionin e luftërave i la shkumë të bardhë.

Në se mbi të u derdhën të huajt si dallgë
nën shkumën e turpit u tërhoqën si valë.

RIFILLIM

*(Naftëtarëve pensionistë që vunë në
shfrytëzim puset e ndalura).*

Nuhatët se nëntoka e puseve të ndalura
i ka rrënjët me naftë.

Dhe ne — pashtershmërinë e forcës suaj
menduar kur ju pamë.

Rrjedha e parë e naftës
ishte
dhe rrjedha e forcës suaj.

Naftëtarë veteranë,
pusi juaj i thellë dhe i pashtershëm
djersë të pastër buron.
Kështu qofshi gjithmonë
pranë nëntokës sonë lehonë!

NË ORËN DHJETË VJEN NËNA...

Për një çast
radioja heshti e lodhur nga lajmet e ditës,
tik-tak, tik-tak...
Si kanarinë e verdhë cicërin ora e tavolinës.
Lehtë-lehtë këtë çast,
kur gjethëza e akrepit puth numrin dhjetë,
dera e shtëpisë troket.
Kush vjen?
Nëna ime,
e madhja dashuri troket në orën dhjetë.

Në botën e trokitjeve të derës
gjallëria e fabrikës shkrihet, moj nënë,
sikur vjen tërë fabrika e bukës
me ty të trokasë në orën dhjetë tek unë.
Radioja,

Ora.

Unë.

Gjithnjë të hapim derën, moj flokhënë.

Ti aromën e ngrohtë të bukës sjell

dhe në përshëndetjen e ëmbël — pak miell.

1970.

VAJZA E ABAZHUREVE

Në hapësirën e mbrëmjes shpërthejnë gonxhe —
abazhuresh me radhë
sikur bëhen gati të çelin
trëndafila qelqesh të bardhë.

I keni parë?
Abazhuret ndizen në parqet me të dashuruar.
Mbi komodinat e dhomave të gjumit
i keni parë?
Dhe në duart e vajzave
që shoqeve ua shpien për urime?

Nuk më rrihet
pa u thënë njerëzve:
këto i bën e dashura ime.

Nën dritën e abazhurit tënd unë rri e mendoj për ty
dhe vjersha bëj si ti abazhure,

që globet e poezitë të çelin tek njerëzit dritë.
Ti shumëfishon buzëqeshjen tënde, unë dritën time
t'u çelin njerëzve në dhoma e në shpirt.

Abazhuret çelin natën.

Në hapësirën e mbrëmjes a thua hapen buzët e tua
me buzëqeshjen e bardhë si shpirti yt, e dashur.

ANATOMIA E DETARËVE

Detarë,
copëra toke në det
copëra deti në tokë.

Ju ecni pranë nesh me detin në trup
me detin në sy
dhe si mushkëri — në gjoks.

E çuditshme — anatomia e trupit tuaj, detarë;
si copëra dallgësh më dukeni kur ju shoh.

E P A H A R R U A R A

E tëra në rrudha.
Mes valëve të rrudhave të tua
ca të erdhën nga mua.

Fletoren e bukurshkrimit
ç'më kujton në fytyrë,
vijat e saj, vallë, t'u bënë rrudhë?
Pse flokët të duken kaq të bardhë,
në to pluhuri i shkumësit tim ka mbetur,
mësuesja e ime e parë.

RRJETA JOTE NUK PO THAHET

Rrjetën e mbledhur thellësive varin në këto supe
ku mbartin shokun e tyre zemërmekur detarët.
Rrjeta s'u është dukur kaq e rëndë sa ky trup
që vete sup më sup sikur e shtynjë valët.

Nuk do të dredhin më duhan nga kutia e tij,
nuk do t'i bëjnë më pyetjen njerëzore: «Hë, si vajti
këtë herë?

Ç'të bëjnë... Ç't'i bëjnë vdekjes... ç't'i bëjnë?
Po të rrinte e flamosura në det
detarët nuk do ta linin pa e shtënë në rrjetë.

Dhe dallgët nuk ua kanë përplasur kaq fort varkën në
breg
sa ky hidhërim — zemrën në kraharor.
Në tallazet e dhjetëra deteve nuk do ta kishin kaq
vështirë
sa në përcjelljen e shokut të tyre detar.

Rrjeta e tij mbushur detrave
zbrazej në qytet: në dyqane, në tavolinat e shtëpive
tona,

e ne mendonim për këtë peshkatar.
Njohuritë e para për thellësitë e detit,
nga rrjeta e tij i mori çdo qytetar.

Herë e parë që floksterkali rri kaq shumë tek toka,
për çmalljen e gjatë ajo e mori në gji.

Detarin,
që tërë thellësitë e detit u solli njerëzve,
në thellësinë e respektit e ka qyteti tani.

ISH-JETIMËT E LUFTËS

Sa herë shohin mësuesin e fëmijëve të tyre fshatarët kujtojnë foshnjën mbi dëborën e asaj dite. Buzët e mardhur thithnin gjinjtë e ngrirë të nënës se foshnjës Ceno i dukej sikur pinte.

Qumështin e nënës së tij pak muaj e piu, për rritjen e Cenos gratë e fshatit afruan gjinjtë. Nuk e harron ndaj i do nxënësit mësuesi Ceno e asnjë fëmijë s'ka mbetur në klasën e tij.

Sa herë humbiste në pyll. . nënë. . nënë, thërriste. E kur e gjente e puthte sa faqet ia kuqnin buzët e Shanos.

Po atë natë e puthi sa s'e kish puthur kurrë e thirri sa u ngjir: . . nënë. . nënë. .
Po plumbi i gjermanit pa nënë e kish lënë.

N'atë pyll me erëra të ftohta ku humbi nënën e gjeti Partia e pëllëmbën ia bëri djep.

Ndaj fëmijët e saj Shanua do t'i rrisë të ndershëm
e punëtorë
pas zërit të Partisë të venë ku i thërret.

Foshnja pa nëna mbetën në luftë,
foshnja pa të ardhme, kurrsesi.
Ish-jetimët e luftës — ndërtues të socializmit
kam takuar kudo në Shqipëri.

VETËM ME PËLLËMBËN GRUSHT

Ky popull mallëkonte,
ky popull uronte:
V.F.-L.P. — në një përshëndetje.

V.F.-L.P.
Me pëllëmbën grusht.
Vetëm me gishtërinjtë e mbledhur
ky popull
mund të mallëkonte kaq rëndë
e të uronte kaq bukur.

LIRIKË E DËBORËS SË PARË NË DURRËS

Pemët, rrugët, njerëzit, në mallëngjim.
Si njerëzve me mysafirin e rrallë
i ngjau me dëborën e parë qytetit tim.

Mbi flokët e shoqes sime qielli — si flutur e bardhë
sikur kurorë e ndonjë luleje të jetë koka e saj.

Dëborë e qytetit tim —
vetëm në filmat e fotografëve e telajon e piktorëve
mbetet

dhe në këtë poezi.
Ndaj nxitoj të shkruaj për dëborën
më parë se ajo të shkrijë.

Filluan të pikojnë strehët —
mallëngjim i qytetit në ndarjen me dëborën.

MEDITIM MBI BEDENAT E NJË KËSHTJELLE

Mbi bedenat e kështjellës si mbi supe të larta rri,
briri këtej ka klithur
për kushtrime lufte gjithnji.

Më vonë këtu varën këmbana —
Qiejt e bronxët lëshonin
kushtrime si bubullima.

Më tepër se nën ninullat e nënave,
u rritën shqiptarët
nën klithmën e alarmeve.

Sirenën e vumë për kushtrime të reja.
Perderisa socializmin e ngremë në rrethim,
në tensione alarmesh na sheh historia.

«. . .AH, TË ISHA PAK MË E GJATË»

(Nga biseda e M. Tutulanit me shoqet).

Asnjë pranverë
me pemët, lëndinat, hapësirat e saj
nuk mund të matej me ëndrrat e tua.

Dhe agimi dukej i zbetë
kur mes shoqesh buzëqeshje, Margaritë.

Ty asgjë nuk të mungonte,
kishe më tepër se ç'ka një pranverë.
Pë shoqeve gjithnjë u thoshe në vesh:
«Pak më e gjatë të isha, sa mirë».

«Pak më e gjatë. . . pak më e gjatë».
E kërkoje si heroinë,
e kërkoje si vajzë.

Dhe ngriheshe pak me gishtërinjtë e këmbës,
si për të arrirë dëshirën tënde vajzërore.
Veten pak më të gjatë, Margë, ç'e doje?

Ndoshta i habitje shoqet me kërkesën tënde, Margë,
heroinat gjithnjë duan më tepër se ç'kanë,
ndaj përpiqen kaq shumë, ndaj venë kaq larg.

Ngjiteshe pas minutave të jetuar në luftë,
ngjiteshe pas viteve me beteja të fituara, Margaritë.
Të shohim shumë lart, vajzë që ëndërroje lartësitë.

«Pak më e gjatë. . . pak më e gjatë»
e arrite si heroinë,
Margaritë.

DRITA JOTE

Në udhë kurbeti bijtë të iknin me dhe në torbë,
toka jote mbetej djerrë,
nuset e reja shkretë.

Ku nuk u përhap dheu yt,
me thërrimet e bukës binte nga trastat e bijëve të tu.
Hajmali të kishin me vete — bijtë që s'të ndenjën
përmbi.

Rinisë së tyre i binin lulet në tokë të huaj,
për gëzim u thanë në shpirt.
Gratë i përcollën dhëndurë e u erdhën pleq të liq.

Nuk nxjerr më kurbetlinjë të kërkojnë fatin nëpër
botë,
populli im, që fatin e madh ia caktoj Partia.
Ajo mbylli shtegun e asaj udhe të nëmur — e hapi
shtegun e udhës së drejtë.

Të udhës ku djersa e gjaku i bijve të kthehet në dritë,
të udhës që hapin e kërkon të fortë e syrin të mprehtë
dhe në këtë udhë ecet vetëm me Parti të vërtetë.

Jo kurbetlinj shpresëkot me dhe në torbë.
Populli im.
dritën e socializmit përhap në botë.

J U A J I

Kur mësova të ec
gjunjët m'u vranë në gurët e parë
po në udhë këmba prush më ndizesh për të tjera udhë.

Kur mësova të notoj,
desh i vajta detit në fund,
po krahët m'u forcuan e ia mata hapësirat.

Vargjet e para, popull,
nuk më dilnin të mira,
letra grisja e lapsa thyeja.

Po letra e lapsi faj nuk më kishin
doja të ta njihja shpirtin nga tavolina,
e pasi të mbyllja librat, për ty të shkruaja.
Po e ndieja,
sa më qullte djersa aq më ngrohte kënaqësia,
fletën e mbështeta në pëllëmbën tënde, për vargjet e
mia.

Dua të më njohësh nga vargjet
si më njeh nga sytë,
e di, për mua nuk është e lehtë.

Fryjnë erëra të liga në botë, me thëllime trazuar,
ndaj mbahen fort tek ty, Partia ime.
Se po ta heq dorën, erërat kanë për t'më rrëzuar.
Pëllëmba jote, o popull, do jetë
tavolina e punës sime gjithnjë
dhe unë, njerëz, juaji.

SULMI I MADH

Të gjata rrethimet... kërcënuese rrethimet
gjithnjë na i kanë bërë;
nga ato të Krujës tek rrethimi i viteve shtatëdhjetë.
Secili tani
më tepër se kurrë
më i pamposhturi kështjellar në bedenin e vet.

E dëgjuam Partinë;
në Kongresin e 7-të, në Kuvendin Popullor.
Fjala e saj për ne —
fletëthirrja e mobilizimit të madh luftarak.
Para fletëthirrjes, ne, njerëzve të sulmit të madh,
na mprehet mendimi krijus,
na bulon çdo bulëz djerse e pikë gjaku.

Kundër rrethimit, armët i kemi të gjithë
të mbushura,

të sakta.
Mendjen,
syrin,
dorën na i mësoi Partia për këto armë;
asnjëherë kaq të nxehta.

Në një minierë kromi u njoha
me minatorin që martelin, mëngjeseve para hyrjes
e mbrëmjeve pasi dilte nga galeria, vajiste.
Kështu më fort e qëllonte shkëmbin.

Qëllonte minatori
me martelin e tij, me vagona plot e përplot,
bllokadën në ballë.
Sulm të tillë asnjëherë
bllokada s'ka parë.

Më shumë i ndrit llampa e ballit.
Në sulm!
Më fort ia mbështet gjoksin martelit.
Në sulm!
Si drita e ballit... si forca martelit
parulla: — «Të punojmë si në rrethim»,
Në sulm!

Minatori i vjetër pranë me të riun,
që me dëftesën e maturës erdhi në minierë,
i mëson: nga mbajtja e martelit tek ndezja e llampës
karbitit,

si partizani i vjetër
më të riut i mëson maliherë.

Për tek sondat e shpimit, pranë puseve nxituan,
veteranët e naftës, ish-pensionistët,
me vrap. . .

Ashtu si luftëtari tek arma, pranë pozicionit
në alarmin e madh luftarak.

Në ballë të arganellos Veliu,
si urdhër luftarak ka shkruar fjalët e Enverit:
«T'i marrim edhe kombin e fundit naftës».
Ashtu si tërë jetën
akoma i kërkon vetes kombin e fundit të djersës.

Pus më pus. . .
hiq tapë,
hidh lugën,
Veli Allajbeu me arganellon e tij,
veterani naftëtar me thinjë.

...
Për vitet e ardhshme lëron traktori i Shyqyriut e
Rizait,
për vite të ardhshme ecën shyta e Pilos e Thimjos,
për rendiment: Këmishtaj e Płasa flamurë janë.

Duke lëruar tokat,
duke ecur në udhët
e viteve që akoma s'janë në kalendar,
shtigjet e udhëve të reja
rrethimit i kemi çarë.

...
Ne jemi të gjithë në vijën e zjarrit,
Hidhemi ne në sulm, peshojmë veten në sulm,
ne të shënjestrës së madhë,
me mendimin e kuq
të mëngjeseve e mbrëmjeve.

...
Si ta bëjmë, në vend, këtë makinë?
Si t'i marrim tokës më tepër kv. për ha?
Shqetësimi ndez mendjen e njerëzve
më fort se volframi në mijëra llampa.

Shqetësimet e bëjnë të rëndë
blokun e komunistit me detyrat e mbledhjes së
Partisë,
fletoren e brigadieres me të dhënat për parcelat e
rendimenteve të larta;
fletën e novatorit me skicat, përmasat e detalit,
makines së re.

I shfletoja e ndjeja
si e luftojmë rrethimin ne.

. . .

Sa herë na prisnin sulmet
përpara u hodhëm me: urra. . urraaa. .
Kështu i kemi çarë e do t'i çajmë rrethimet
nga thirrjet partizane tek më të rejat inisiativa.

. . .

Vijë fronti i mendojmë
galeritë e nëntokës e lartësitë e metalurgjikut;
vijë fronti mendojmë
realizmin socialist e brazdën e tokës;
si në një vijë fronti luftojmë
në digat e Fierzës e ndërgjegjen e secilit
ne.

Në këtë vijë,
pranë komunistit me vite partie
rrinë shokët e shoqet kandidate.
Me njëri-tjetrin,
mendje e shpirt pranë e pranë,
si fishekë gjerdani në bllokadë.

Me jetën. . . me luftën
dhe shembullin e tij çdo komunist
fletë-fletë lidh librin e madh të Partisë.
Ndaj pranë komunistëve
çdo njeri nga ne — studimin e këtij libri nis.

. . .

Pas çdo rrethimi
dhe në atë më të egrin
me fakte të gëzueshme e pasurojmë historinë.
Lindje fshatrash e qytetesh socialistë,
lindje të gëzueshme, që s'do t'i prisnim pa Partinë.

Mbi ish-moçalet të thara, të shkripura hapëm
toka buke e themele Hoxhare
për gjelbërimin, për rininë.
Gjerbërimi i tokës e rinia pranë e pranë,
të dy me një simbol, me një dashuri rrinë.

Emra të rinj: Ksamil, Rini, Hoxharë. . .
të rinjtë i shtuan toponimisë shqiptare.
Afër fshatrave me name historie e legjenda
fshatra e banorë me biografi dy-tre vjeçare.

Fshatra të rinj me «legjendë» të re
«Legjendën» socialiste:
Se si në toka kripte e pëllëmba dheu mes shkëmbinjve,
rini, bukën dhe lumturinë e jetës rrite.

Fshatra të rinj me kronikë të re;
kronikën më të re socialiste shkruajnë të rinjtë në
çdo fshat.
Për dasmat e shpeshta me krushq e gëzime të veçanta;
për rendimentet rekord me agroteknikë të lartë.

. . . .
Për lavdinë, për fitoret e luftës në rrethim
nuk i ngremë vetes monumente a lapidare.
A nuk lartohen të tillë:
buka e mielli shqiptar, çeliku i markës shqiptare?

Mbi digat e Fierzës, mbi ndërgjegjen e klasës
lavdia, djersa, sukseset-përmendore ngritur;
për qytetin, kolektivat, brigadat
organin e shtypit e individë —
në sulmin e madh heronj të shpallur.

. . .
Në vite bllokade ne morëm penën
t'i shtonim gërmën lapidare tregërmëshit madhështor.
Donin të na e thyenin majën e kësaj pene,
të na dridhej dora kërcënonte çdo agresor.

Ishte mendimi i Partisë,
ishte plugu, sonda, marteli — pena jonë;
ishte dora që lëronte brazdat, shponte puse nafte e
thërrmonte shkëmbinj minerali,
që fortë e mbante,
S-në historike të shkruante.

Të gjithë ata që na luftuan
e që donin t'i hidhnin bojë të zezë trigërmëshit RPSH,
na dëgjuan të shqiptonim mbiemrin më të ri:
Socialiste.

Socialiste,
shqiptojmë ne që ja vumë këtë mbiemër
e ndiejmë ngrohtësinë e madhe
të çelikut porsaderdhur,
të bukës së porsagatuar.

Nuk do ta bënim bukën me drithin tonë,
nuk do ta derdhnim çelikun e parë,
s'do t'i thërrisnim me mbiemrin e ri Republikës
ne njerzit e sulmit më të madh të historisë,
po të mos i mbrunim mendimet
me mendimin e Partisë!

Djersa e derdhur në rrethim
ka vlerë gjaku,
gjak — kthehet për Shqipërinë.

Para vijës së zjarrit e ndiejmë veten,
ku vijën e shenjimit na mësoi Partia.
Në shënjestër
mban syrin e mprehtë Shqipëria!

Shkurt 1977.

PASQYRA E LËNDËS

Buronja	5
Kur prindërit uronin vëllanë e madh	5
Vajzat e ansamblit artistik të kooperativës	6
Fletorja e bariut	7
Shqetësim i njërit brez për tjetrin	9
Nga balta e arave	10
Nuhatja	12
Kur po mbledhja material për skenar	13
Liçeni i luleve dhe legjenda e virgjërisë	15
Dhjetë vargje për nipin e parë	16
Iniciale shkruar me gjak	17
Antifetare	18
Për komunistin Gjini	19
Bukë për atdheun	21
Borovë	22
Në ditarin e ditës së parë të dashurisë	23
Teuta	24
U buzëqeshte toka	26
Përcjellja	27
Hider Kokës	28
Detarëve që s'duan të dalin në pension	30
Pranë vijës së kufirit	32
Njohja e plagëve të tua, baba	34
Epitafi me gëzhoja	36
Vajza që mësoi të qëndisë pranverën	37
Gëzim i veçantë familjar	39

Kur lindin qengjat	41
Në klubin e detarëve	42
Gjumi i njeriut të vockël	43
Rrjedha e këngëve të tij	44
Qëndresa e nënës	46
Një mendim	47
Detkës, shoqes sime	48
Partizanes që këndonte në qytetet e çliruara	50
Krenaria e tokës sonë	52
Rifillim	53
Në orën dhjetë vjen nëna... ..	54
Vajza e abazhureve	56
Anatomia e detarëve	58
E paharruara	59
Rrjeta jote nuk po thahet	60
Ish jetimët e luftës	62
Vetëm me pëllëmbën grusht	64
Lirikë e dëborës së parë në Durrës	65
Meditim mbi bedenat e një kështjelle	68
«...Ah, të isha pak më e gjatë»	67
Drita jote	69
Juaji	71
Sulmi i madh	73